REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 69-72-73/17
Datë/Datum. 28.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 69/17
72/17
73/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues në Konzorcium: "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova"- Gjakovë, OE: "Berisha Company N. P. T & Eko Drinia Sh.p.k"- Gjakovë, dhe OE: "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve dekorative", me nr prok "632/16/080/211", i iniciuar nga autoriteti kontraktues /Komuna e Gjakovës /, më datën 20 prill 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohen,** pjesërisht si të bazuara ankesat e OE "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova"- Gjakovë, OE: "Berisha Company N.P.T & Eko Drinia Sh.p.k"- Gjakovë, dhe OE: "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve dekorative", me nr prok: "632/16/080/211", i iniciuar nga autoriteti kontraktues /Komuna e Gjakovës/.

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontratës i AK-së / Komuna e Gjakovës /, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve dekorative", me nr prok: "632/16/080/211" dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorëve ekonomik ankues "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova"- Gjakovë, OE "Berisha Company N.P.T & Eko Drinia Sh.p.k"- Gjakovë, dhe OE "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë, ju kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesat janë aprovuar si pjesërisht të bazuara.

V. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 7 të rregullores së punës së OSHP-së 01/2017, që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me datën: 16.12. 2016.

Hapja e ofertave është bërë me datën: 30.01.2017, ku kanë marr pjesë gjashtë (6) operatorë ekonomik.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova"- Gjakovë" është bërë me datën: 21.02.2017.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm "Berisha & Eko Drinia" – Gjakovë, është bërë me datën: 21.02.2017.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë është bërë me datën: 21.02.2017.

Njoftimi për dhënie të kontratës është publikuar me datën: 23.02.2017, e ku është rekomanduar për kontratë konsorciumi "N.T.P Beni" – Gjakovë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova"- Gjakovë", me datën: 27. 02. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "Berisha & Eko Drinia" - Gjakovë, me datën: 28. 02. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë, me datën: 01. 03. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me datën: 02.03.2017, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesat për rishqyrtim të operatorëve ekonomik.

Operatori ekonomik "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova"- Gjakovë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 08 Mars 2017 me nr. 69/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve dekorative", me nr prok "632/16/080/211", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 6 i LPP-së – (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
- Neni 59 i LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 72 i LPP-së – (Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë)

Operatori ekonomik "Berisha & Eko Drinia" - Gjakovë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 10 Mars 2017 me nr. 72/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve dekorative", me nr prok "632/16/080/211", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 6 i LPP-së – (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
- Neni 7 i LPP-së – (Barazia në trajtim / Jo Diskriminimi)
- Neni 59 i LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 60 i LPP-së – (Kriteret për dhënie të kontratës)

Operatori ekonomik "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 13 Mars 2017 me nr. 73/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve dekorative", me nr prok: "632/16/080/211", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së – (Qëllimi)
- Neni 59 i LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 61 i LPP-së – (Tenderët jo normalisht të ulët)
- Neni 72 i LPP-së – (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë)
- Neni 27 i UOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 27 mars 2017, mendon që autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e divaneve të drunjve dekorativ" me nr prok: "632/16/080/211" nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të anulojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të Rivlerësohet, ndërsa ankesat e OE-ve ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuara.

Operatori ekonomik ankues "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova", me datën: 30 mars 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Berisha & Eko Drinia" - Gjakovë, me datën: 30 mars 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.04.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik ankues "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova", ka deklaruar: "Në bazë të parashtresës ankesës kemi specifikuar se janë atakuar neni 6, 7, 52, 56, 59, 60 të LPP-së. Sa i përket raportit të ekspertit ne kemi prononcuar se pajtohemi pjesërisht me të gjeturat e ekspertit në raport me kompaninë tonë. Pjesa makinerisë ku sipas ekspertit ka mungesë sipas nesh ne kemi plotësuar kriteret sepse kërkesat e AK kanë qenë jo standarde-nuk ka kamion që kategorizohet 1.5 ton, kategorizimi i automjeteve është deri 3.5 ton, dhe mbi 3.5 ton. Kështu që ne kemi dorëzuar listën e pajisjeve dhe kemi plotësuar kërkesën e AK.

Po ashtu tek pjesa C ne kemi dorëzuar formularin, ku është i nënshkruar dhe pulsor pjesa C në kornizën ku kërkohet nënshkrimi e vula. Po ashtu kemi marrëveshjen mbi themelimin e konzorciumit ku aty ceket edhe kërkesat tjera të AK-së ku OE-të bashkërisht dhe veçmas janë përgjegjës për ofertën tonë, ku edhe plotësohet kërkesa e AK-së. AK qëllimisht na ka anashkaluar ofertën tonë duke na eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit dhe duke rekomanduar për kontratë OE i cili është identifikuar edhe nga eksperti se ka gabime aritmetikore mbi 6%, kështu që siç shihet qëllimshëm AK ka dashtë të atakoj".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Berisha & Eko Drinia" – Gjakovë ka deklaruar: "Ne në tërësi jemi pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues dhe gjitha vërejtjet tona janë në ankesë dhe eksperti ka vërtetuar pretendimet tona ankimore".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë, ka deklaruar: "Ne kemi bërë parashtresën në ekspertizë. Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit pasi nuk ka marr parasysh pretendimet tona të shprehura në ankesë. Vlera parashikuar e kontratës është 317,974€. Mund të them lirë se gjithë ofertuesit kanë ofertuar me 55% më lirë se vlera e parashikuar. Në sqarimin e ekspertit në këtë sqarim ka bërë një gjysmë fjalie se "AK nuk ka dyshuar në çmimet e ofruara nga OE-të", ky ka qenë sqarimi vetëm për këtë pikë. Kjo mendoj se është në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së. Po ashtu ka cek se nuk kam atakuar pjesëmarrësit tjera, pasi mendoj se nuk ka arsye pasi kemi bërë ankesë për OE të rekomanduar për kontratë dhe nuk kemi pas nevojë të atakojmë OE tjerë".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK - KK Gjakovë ka deklaruar: "Ne nuk jemi pajtuar me mendimin e ekspertit. Sqarimi i ekspertit shqyrtues, për ankesën e OE Marisa & Benita AK – KK Gjakovë pajtohet me mendimin ekspertit se AK e ka eliminuar me të drejtë. Gjithashtu AK sqaron se OE Marisa & Benita nuk ka asnjë kuptim të pretendoj për shkelje procedurale pasi OE në fjalë nuk i ka plotësuar kërkesat minimale të dosjes së tenderit dhe i njëjti është i papërgjegjshëm sipas nenit 111 pika 1.5 nuk paraqet palë të interesit. Sqarimi 2 i ekspertit, sa i përket sqarimit 2 për ankesën e OE Berisah & Ekodrinia, AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit. Gjithashtu OE në fjalë nuk ka asnjë kuptim për shkelje sipas nenit 111 pika 1.5 pasi nuk është palë e interesit. Sqarim për secilën pikë të ekspertit shqyrtues: eksperti ka konsideruar se Bachelor i Bujqësisë i ka plotësuar kërkesat minimale të dosjes. AK – KK Gjakovë sqaron se ky mendim i ekspertit është në kundërshtim me Udhëzimin 06 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjegjshëm neni 15 fusha e Bujqësisë, e cila sqaron se bachelor me inxhinier të

diplomuar nuk janë në kualifikim. Bachelor diplomën e merr me 6 semestra ndërsa inxhinieri me 10 semestra. Eksperti lidhur me deklaratën e konzoricumit ka konsideruar se në bazë nenit 71 të LPP arsyetimi i AK është i paqëndrueshëm dhe nuk ka arsye të eliminimit. AK sqaron se ky mendim i ekspertit është në kundërshtim me nenin 18.3 të rregullores dhe udhëzuesit për prokurim ku thuhet "pjesa C formulari për dorëzimin e ofertës është pjesë kryesore tenderi sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën financiare, ajo përbëhet nga formulari i tenderit dhe lista e çmimeve ". OE duhet të plotësoj dhe nënshkruaj formularin në dy pjesë sepse në qoftë se formulari nuk është ri-plotësuar kjo do të thotë se nuk ka ofertë. Në rast se personi që dorëzon dhe nënshkruar ofertë dhe nuk është kompetent për dorëzim të ofertës. Eksperti lidhur me kapacitetin e cisternës deri 3000 litra, ku OE ankues ka ofruar mbi 3000 litra cisternën, eksperti ka konsideruar se OE ankues e ka plotësuar këtë kërkesë mirëpo tejkalimi i saj mbetet të vlerësohet nga AK. Sqarimi jonë është që për kamionët 1.5 cisterna 3000 litra. Janë kërkuar kamion 1.5, nuk kemi cek a është totali apo sasia bartjes, sipas nenit 108/A secili OE ka pas mundësi të kërkoj sqarime, ndërsa gjithë janë pajtuar me dosjen, kanë ofertuar dhe pasi janë eliminuar janë ankuar që është në kundërshtim me ligjin për kritere të dosjes. Ndalimi qarkullimit të kamionëve mbi 3.5 ton në rrugët e qytetit është i ndaluar me shenjat e komunikacionit dhe sipas rregullës komunale për taksa, tarifa dhe siguresa neni 10 pika 10.1. Tarifa për qarkullimin e mjeteve të rënda është e ndaluar, kjo rregullore rrjedh nga ligji për rregullat e trafikut rrugorë neni 93, vendi ku ndalohet parkimi mjetit pika 1.4. Mjeti apo bashkësia e mjeteve mbi 3.5 kg apo gjatësi mbi 12 jashtë mjetit të. Sqarimi tretë i ekspertit për ankesën e Erlis&Vemor, nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, pasi sipas neni 111 pika 1.5 ky OE nuk është palë me interes. AK – KK Gjakovë për tre OE-të ankues sipas nenit 111 pika 1.5 nuk janë palë me interes. Formulari C, ku eksperti thotë se nuk qëndron arsye eliminimit nuk qëndron, pasi kjo është kundër nenit 18.3 të rregullores dhe udhëzimit. Po ashtu për OE ankues në fjalë eksperti për kapacitetin e kamionëve , nuk lejohet me zona urbane kamion mbi 3.5 ton. Sqarimi 4 i ekspertit, AK sqaron se ky mendim nuk qëndron, sipas nenit 59.3 të LPP-së. Si përfundim AK-KK Gjakovë duke u bazuar në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës propozon panelit që vendimi i AK të mbetet në fuqi".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Siç jeni informuar me raportin propozimi im për rivlerësim bazohet kryesisht në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë i cili ka gabime aritmetikore. Ndërsa lidhur me ofertat e OE-ve ankues sqaroj se ka devijime që mund të konsiderohen të vogla pasi kanë çmime më të ulëta se OE i rekomanduar për kontratë, përveç OE:"Erlis&Vemor". Gjithashtu pretendimi i përfaqësuesit të EO Vemor i cili deklaron se sipas vlerës eksperti nuk ka marr parasysh këtë pretendim, sipas nenit 61 dhe rregullores për çmime jo

normalisht të ulëta, konstatimi i një oferte me çmim jo normalisht nuk bazohet në vlerën e parashikuar të kontratë, por bazohet në mes të vlerave të ofertave të OE-ve ofertues".

Anëtari i panelit parashtroj pyejte përfaqësuesit te AK dhe ekspertit shqyrtues lidhur me gabimet aritmetikore qëndrojn apo jo, ka apo nuk ka gabime mbi 2%?, në përgjigje eksperti shqyrtues deklaroj: "Gjatë ekzaminimit të ofertës së OE të rekomanduar kam konstatuar disa gabime aritmetike edhe në raportin e ekspertizës, të cilat AK gjatë vlerësimit nuk i ka ekzaminuar". Ndërkaq në kundërpërgjigje përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: "Jo, OE nuk ka gabime as 0%. Për në çmime mbizotërues ka qenë çmimi total për njësi me TVSH".

Anëtari i panelit z. Sylejmani ka pyetur përfaqësuesin e AK- së se OE "Berisha" a ka ofertuar me inxhinier Bachelor?, në përgjigje e njëjta deklaroj: "Niveli Bachelor nuk plotëson kërkesën për inxhinier të Bujqësisë, pasi niveli Bachelor nuk është inxhinier".

Anëtari i panelit z. Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK-së, se OE "Marisa" a ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale?, në përgjigje përfaqësuesja e AK-së, deklaroj: "Jo nuk janë të përgjegjshëm, pasi në njëjtin aktivitet Marisa&Bernita dhe O Viktori që është pjesëmarrës po ashtu, kanë ofertuar me te njëjtat paisje".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova" ka deklaruar: "AK thotë se nënshkrimi dosjes nuk është bërë nga personi komentet, kjo nuk qëndron, pasi EO vepron në bazë të rregullave të brendshme dhe ka të përcaktuar përgjegjësitë, andaj nëse ka pas ndonjë dyshim AK ka mund të kërkoj sqarim prej OE. Sa i përket kërkesave te pjesa makinerisë shihet se AK qëllimshëm ka lënë pa sqaruar gjërat me qëllim të shpërblej dike me kontratë. Po ashtu tek pjesa dorëzimit të ofertës ku në hapje ka qenë me mic 145.802€, ndërsa edhe eksperti ka konstatuar se ka gabime të cilat kalojnë vlerën totale (që sipas nesh është mbi 6%), që automatikisht është në kundërshtim me LPP-së. I propozoj panelit të kthej lëndën në rivlerësim dhe të merren masa disiplinore ndaj zyrtarit të prokurimit të AK-së pasi shihet që qëllimshëm, dhe ti tërhiqet licenca e ushtrimit të detyrës".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues "Berisha Company N.P.T & Eko Drini Sh.p.k"- Gjakovë ka deklaruar: "AK nuk ka specifikuar se Inxhinieri Bachelor është i papranueshëm, sikur të ishte kërkuar kjo mund kishte qen kriter, mirëpo kjo nuk ka qen kërkesë e

dosjes. Kërkojmë nga paneli që si OE ankues lënda të kthehet në rivlerësim dh pasi jemi me çmim më të lirë të shpërblehemi me kontratë".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues "Erlis&Vemor" ka deklaruar: "Çmimi 1 euro për metër kub kubëza që janë ofruar nga OE-të janë çmime manipulative andajI propozoj panelit që sipas ligjeve në fuqi dhe çmimeve të vlerësohen ofertat".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së: "Qëndrojmë pranë vendimit të AK dhe i propozojmë panelit të vërtetoj të njëjtin si të bazuar, dhe asnjë nga OE-të ankues nuk janë të përgjegjshëm".

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe faktëve të shkresave të lëndës, deklarimeve dhe provave të ofruara në seancën për shqyrtim kryesor, konstatoj se AK-KK Gjakovë nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së kur e ka eliminuar OE "Marisa" me pretendimin se anëtarët e konzorciumit "Marisa & Benita & Horn CO" nuk i kanë ofruar deklaratat nën betim, ndërsa paneli ka konstatuar se këto deklarata janë ofruar nga të njëjtit. Paneli shqyrtues poashtu ka konstatuar se konzorciumi "Marisa & Benita & Horn CO" e ka përdorur formularin standard të paramaësës dhe parallogarisë, andaj në këtë pikë paneli ka vlerësuar se AK e ka eliminuar pa të drejtë.

Paneli shqyrtues poashtu ka konstatuar se OE ankues "Berisha" i ka dhënë çmimet sipas kërkesave te AK-se, Poashtu AK e e jep arsyetimin se OE,nuk i ka në ofertën origjinale dokumentet e themelimit të konzorciumit sipas nenit 71 të LPP-së, mirëpo paneli ka konstatuar se në shkresat e lëndës është dokumentuar se ekzistojnë dokumentet përkatëse për themelim sipas nenit 71 të LPP-së.

Paneli shqyrtues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka gabime aritmetikore në totalin e çmimeve për njësi, ku në pozicionin nr 1 ka dhënë çmimin prej 10 euro, e qe ne fakt sipas sasisë, çmimit te ofruar dhe çmimit te TVSH-se, rezulton te jetë 9.67 euro, pastaj ne pozicionin nr 2 ka dhënë çmim prej 2,160.00 euro, e qe ne fakt duhet te jetë 2,090.01, dhe se sipas shkresave të lëndës shihet se pothuajse në çdo faqe të parallogarisë dhe paramasës është vërtetuar se OE i rekomanduar për kontratë ka gabime aritmetike, andaj paneli shqyrtues konstatoj se AK- KK Gjakovë nuk ka respektuar nenin 59 te LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi

i tenderëve), më rastin e vlerësimit të ofertave dhe se AK-KK Gjakovë duhet të ri-ekzaminojë OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me gabimet aritmetike dhe se ky aktivitet i prokurimit duhet të rivlerësohet.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Komuna e Gjakovës"

1x1 OE – "Marisa shpk & Benita shpk & Horn Kosova"- Gjakovë

1x1 OE - "Berisha & Eko Drinia" - Gjakovë

1x1 OE - "ER-LIS Sh.p.k & VE-MOR Sh.p.k"- Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.